



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Avokatura Istrefi shpk" të datës 04.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Avokatura Istrefi shpk" të datës 04.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Avokatura Istrefi shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 04.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 4

Pretendimet ankimore të parashtruesit: Parashtruesi i kundërshton arsyet për eliminim nga aktiviteti i prokurimit. Sa i përket deklaratës nën betim parashtruesi pretendon që të dy anëtarët e GOE kanë dorëzuar deklaratat nën betim me të dhënat të sakta ndërsa praktika e OSHP e ndalon eliminimin për lëshime formale apo teknike që nuk cenojnë substancën e dokumentit. Ndërsa për marrëveshjen e GOE parashtruesi pretendon se marrëveshja është nënshkruar dhe vulosur nga të dy anëtarët e GOE.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

#### ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

- Ju si GOE-ik Nuk i ka plotësuar kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për kontratë: Kërkesën e përshatshmërisë Kërkesa: *Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L- 42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>. Dëshmia: Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042. Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit. Anëtarët e grupit të Operatoreve Ekonomik me oferte kanë dorëzuar Deklaratat nën betim mirëpo jo sipas kërkesës. Lideri i Grupit (Avokatura Istrefi SH.P.K.) ka dorëzuar Deklaratën nën betim si në vijim:*

#### Aneksi 2.

#### DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar [Konzorciumin e O.E: "Avokatura Istrefi dhe Osmani"] deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Lideri i Grupit ka dorëzuar Deklaratën nën betim në emër të grupit e jo siç kërkohet të dorëzohet vetë e vetë

#### Aneksi 2.

#### DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Anëtar i tjetër i konzorciumit ka dorëzuar Deklaratën nën betim pa e plotësuar si duhet deklaratën nën betim dhe konform RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK: Mungesa e plotësimit të deklaratës nën betim apo ekzistencës / Refuzo tenderin pa kërkuar sqarime shtese / Kusht administrativ

- Ju si GOE-ik Nuk kanë përmbushur edhe kërkesën tjetër të DT-së Aneksi 7 të DT-së. MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit konform deklaratës të aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024. GOE-ik ka dorëzuar 2 deklarata për formimin e grupit. Deklarata për formimin e grupit konform deklaratës së aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024 nuk është plotësuar, nënshkruar dhe vulosur pjesa ku është përcaktuar Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i Autorizuar).

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) .....

Data/Nënshkrimi / Vula .....

Sipas RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK: *Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm / Kusht administrativ.*

Deklarata e dyte e dorëzuar nga GOE-ik nuk i plotëson kërkesat e nenit 65 të LPP-se si dhe është në kundërshtim me MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit konform deklaratës së aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024.

- Ju si GOE-ik nuk keni dorëzuar specifikimet teknike të cilat kanë qene të bashkangjitura me dosjen e tenderit (Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË

DETYRUESHME - Sipas përshkrimit teknik - Paramases dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT), andaj tenderi juaj është refuzuar duke u bazuar në UDHËZUESIN Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMI E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet:

*"Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar) Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, Neni 28 i LPP-së*

*Andaj për arsyeje të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Më konkretisht, është gjetur se parashtruesi e ka dorëzuar një deklaratë nën betim në emër të "Konsorciumin e OE "Avokatura Istrefi dhe Osmani"" dhe një deklaratë nën betim tjetër ku nuk e ka prezantuar fare emrin e OE. Pra që të dy këto dy dokumente themelore, janë plotësuar në mënyrë të gabuar. Më tutje, GOE ka dorëzuar edhe një deklaratë për themelimin e GOE ku ka prezantuar dy OE mirëpo nuk është plotësuar fare pjesa e përfaqësuesit të autorizuar të GOE (ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi). Pra marrëveshja për themelimin e GOE nuk është plotësuar në mënyrë të duhur dhe të plotë.

*\_\_\_\_\_*

*\_\_\_\_\_*

Po ashtu, është gjetur se parashtruesi nuk e ka bashkëngjitur specifiket teknike të detyrueshme të nënshkruara/vulosura sikurse kërkohen me UPP lidhur me nenin 28 të LPP ku përcaktohet që nëse mungon specifikacioni teknik i detyrueshëm, oferta refuzohet pa kërkuar fare sqarime shtesë.

Fakti që parashtruesi ka dështuar për të plotësuar në mënyrë të rregullt deklaratat nën betim dhe marrëveshjen për themelimin e GOE përbëjnë kushte administrative si dhe mungesa e specifikacionit teknik e bëjnë ofertën e parashtruesit administrativisht të papërgjegjshme. Si e tillë oferta e parashtruesi me të drejtë është eliminuar si e papërgjegjshme sipas të gjeturave të komisionit vlerësues.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 08.01.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.